




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjilan, me datë: 31.08.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të dt. **27.08.2020**, të parashtruar nga OE "Bejta Commerce" Sh.a. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi dhe hapja e rrugëve të rendit tretë, pastrimi i lumenjëve dhe largimi i deponive të egra", me nr të prokurimit 651-20-4015-5-2-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 020 043 521 nxjerr:

V E N D I M

Aprovohet pjesërisht : kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomikë OE "Bejta Commerce" Sh.a. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi dhe hapja e rrugëve të rendit tretë, pastrimi i lumenjëve dhe largimi i deponive të egra", me nr të prokurimit 651-20-4015-5-2-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 020 043 521 e dt. **27.08.2020** kundër Njoftimit për Kontratë dhe DT të datës **12.08.2020** të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.

1. **AK - Komuna e Gjilanit vendos të vazhdojë sipas Njoftimit për Kontratë dhe DT të datës 12.08.2020**
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Operatori Ekonomikë OE "Bejta Commerce" Sh.a. ,me datë **27.08.2020** , ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi dhe hapja e rrugëve të rendit tretë, pastrimi i lumenjëve dhe largimi i deponive të egra", me nr të prokurimit 651-20-4015-5-2-1

dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 020 043 521. Autoriteti Kontraktues me datë 12.02.2019 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal Gjilan në DT si dhe në Njoftimin për Kontratë të datës 12.08.2020 më saktësisht tek Aneksi nr. 7 kërkohet nga Operatorët Ekonomik që ti përmbahen kësaj të fundit :

Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit. Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT. Dhe, si dëshmi Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen. Ne rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet te dorëzoj edhe marrëveshjen për shfrytëzim.

1 (një) Kamionet T4 – T4 është emër i prodhuesit e prodhon wolgsvagern dhe kërkesa e mjetit me emër prodhuesi nuk është sipas ligjit e lejshme sepse çdo kamionët mund ta kryej punën njejt.

1 (një) Ngarkues 10 deri 12 ton – të hiqet kufizimi dhe te lihet mbi 10 ton, ne si kompani i kemi 7 ngarkues dhe me kufizimin qe e keni ber na keni pamundësuar marrjen pjes ne tender.

3 (tre) Greder 9 deri 16 tone – të hiqet kufizimi dhe te lihet vetëm mbi 9 ton sepse kjo paraqet diskriminim dhe megjithëse i kemi 4 greder na e pamundëson marrjen pjese ne tender.

Me date 15.08.2020 ne ora 9:12 minuta kemi kërkuar sqarim per mjetet e lartcekura dhe kemi erkuar qe te largohen kufizimet por nuk kemi marr përgjigjeje dhe me date 26.08.2020 kemi shkuar ne zyret e prokurimit dhe na kan thene se kërkesa nuk ka arritur te ta fare. Ne prezenc te drejtorit te prokuirmit dhe zyrtares jau kemi dehsmuar se kërkesën me datën e larcekur e kemi ngarkuar ne E-Prokurim dhe e kan pare edhe vet ne faqen tone te E-Prokurimit dhe nuk kan ndërmarr asgjë ne kete drejtim , se si ka mundësi qe kërkesa e jone e ngarkuar nuk ka arritur te zyra e prokurimit nuk munta kuptojm por ne nuk mun ti bartim pasojat e mosfunktionimit te faqes se E-Prokurimit ose te ndonjë parregullsie tjetër ne faqen elektronike te E-Prokurimit. Dokumentin e shkarkuar me dat dhe ore do ja bashkangjesim si dëshmi kësaj kerkesese.

Kërkojmë qe këto kufizime te mjeteve qe dyshojmë se jan bere me qellim pasi i kan pare mjetet tona dhe i kan kufizue kërkesat ne menyre qe te mos mund te marrim pjese, te largohen dhe te na mundësohet marrja pjese ne tender sepse AK e ka per obligim ligjor qe te krijoj kushte qe sa me shume operatore te marrin pjese ne tender dhe nuk guxon qe te vendos kritere diskriminuese siç e parasheh edhe ligji ne nenin 7.

Duke parë pretendimet tuaja Ankimore ne si AK kemi shqyrtuar në detaj këto të fundit :

Ne si AK – Autoritet Kontraktues , Komuna Gjilan duke u bazuar në DT si dhe në Njoftimin për Kontratë rreth Sqarimit të DT fillimisht ju njoftojmë se afatet ligjore për këtë pike është kaluar.

Rreth parashtrimit të Sqarimit të DT nga ana juaj ku pretendoni se keni ngritur në platformë me datë 15.08.2020 ju njoftojmë se ne si AK nuk kemi pranuar këtë Kërkesë nga ana juaj.

Mirëpo, në mënyrë që të jemi sa më transparent pasi që keni qenë dhe ju present në Zyret e Prokurimit dhe keni parë dhe vet që Kërkesë e tillë nuk na u është adresuar neve dhe për atë arsye nuk ka ekzistuar mundësia që të miret në shqyrtim nga ana jonë.

**Rrjedhimisht, AK në bazë të LPP-së ka vazhduar procedurat për këto aktivite.
Për këtë ju keni mundur që të ju drejtoheni edhe HelpDesk-ut si OE për këtë çështje.**

Rrjedhimisht bazohuni ne Korigjimin e Dosjes se tenderit te deates 31.08.2020.


Andaj, bazuar në të gjitha që u cekën më lartë AK- Komuna e Gjilanit shpalle pjeserishte te bazuar pretendimet e juaja ankimore.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimet te ketij vendimi.**

Izet Kurteshi



U.D Menaxher i zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës.